



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji kërkimi B

Ngarkesa: (6 kredite, 60 orë mësimore, 30 leksione dhe 30 seminare)

Viti / Semestri: Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik Trigjuhësh

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndor:

Të pajisë studentët me njohuri bazë dhe të avancuara mbi konceptet, metodat dhe procesin e kërkimit shkencor në fushën e komunikimit. Të zhvillojë aftësitë analitike dhe praktike të studentëve për të realizuar kërkime të strukturuar dhe të argumentuara shkencërisht. Të nxisë ndërgjegjësimin për çështjet etike dhe profesionale në procesin e kërkimit dhe të publikimit të rezultateve.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të dallojë karakteristikat e kërkimit sasior dhe cilësor dhe të kuptojë rolin e kërkuesit në secilin rast.
2. Të përvetësojë teknikat e grumbullimit, organizimit dhe analizës së të dhënave, përfshirë metodat statistikore të zakonshme.
3. Të mësojë si të shkruajë dhe të strukturojë një punim kërkimor dhe ta përgatisë për prezantim ose botim.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti është në gjendje të zbatojë metoda kërkimore cilësore dhe/ose sasore në funksion të një problematike në fushën e komunikimit.
2. Studenti di të mbledhë, analizojë dhe interpretojë të dhëna duke përdorur mjete kërkimore të përshtatshme dhe të argumentojë përfundimet në mënyrë të qartë.
3. Studenti përgatit dhe paraqet një punim kërkimor të strukturuar sipas standardeve akademike dhe me ndjeshmëri ndaj aspektit etik të kërkimit.